

AKCIZA NË DUHAN

EFEKTET NË KONSUM DHE IMPORT



1. Hyrje

Duhani është shkaktari më i madh i sëmundjeve parandaluese dhe i vdekjeve të parakohshme. Një në dy duhanpirës vdes nga sëmundjet që shkaktohen nga pirja e duhanit.¹ Për çdo dollarë të shpenzuar në duhan, kostoja shëndetësore është rreth 5.5 dollarë.² Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovë, 14% e popullsisë mbi moshën nëntë vjeçare janë duhanpirës. Gjinia paraqet një faktor të rëndësishëm në pirjen e duhanit, ku 6% e femrave janë duhanpirëse, krahasuar me 23% të meshkujve.³ Krahasuar me vendet tjera, Kosova renditet në kuartalin e parë (kuartali i ulët) sa i përket përqindjes së meshkujve duhanpirës.⁴ Përqindje të ngjashme të duhanpirjes ndër meshkuj, në vitin 2012, kishte edhe Finlanda, Liberia, Norvegjia, Kenia, e të tjera.⁵ Qëllimi i këtij studimi të shkurtër është që të analizojë efektin e akcizës në duhan në konsumin e duhanit në Kosovë.

2. Akciza në duhan

Akciza në duhan ka filluar të zbatohet për herë të parë në janar të vitit 2000, kur Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) aplikoi akcizë në disa produkte. Fillimisht, UNMIK kishte vendosur akcizë në duhan vetëm në bazë të vlerës (25% e vlerës),⁶ kurse pastaj u ndryshua njësia e akcizës në mes të cigareve dhe cigarllosëve.⁷ Përderisa në cigarllosë akciza vendosej në bazë të vlerës, në cigare akciza vendosej në bazë të sasisë (katër marka për 1,000 copë cigare). Tri vite më vonë, UNMIK-u prapë e rritë akcizën në cigare, fillimisht nga dy euro në gjashtë, pastaj nga gjashtë në 10 euro për 1,000 copë cigare.⁸

¹ NHS, Efektit e duhanit në trup, Burimi: <http://bit.ly/1pL260f>, qasur me 15.03. 2016

² American Cancer Society, Duhani: Kostoja e vërtet e duhanpirjes, Burimi: <http://bit.ly/1sdPX8A>

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (2014), Burimi: <http://bit.ly/21zaiE4>, qasur me 13.03. 2016

⁴ Shih Aneksin 1

⁵ World Health Organisation, Përhapja e pirjes së duhanit tek të rriturit dhe adoleshentët, Burimi: <http://bit.ly/1XAdkH9>, qasur me 15.03. 2016

⁶ UNMIK, Rregullorja nr.2000/02 mbi akcizën e duhanit në Kosovë, 22.01.2000, Burimi: <http://bit.ly/1R5hSGU>

⁷ UNMIK, Rregullorja nr. 2000/56 e cila e ndryshon rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/2, mbi akcizën e duhanit në Kosovë, Burimi: <http://bit.ly/1THSA2o>

⁸ UNMIK, Rregullorja nr. 2003/23 mbi akcizën në produktet e duhanit në Kosovë, 25.06.2003, Burimi: <http://bit.ly/1LbqODE>, qasur me 14.03.2016

Në dhjetor të vitit 2008, ka filluar aplikimi i Ligjit për tatimin e normës së akcizës.⁹ Tabela 1 paraqet listën e vendimeve të Qeverisë së Kosovës për ndryshimet e normës së akcizës në duhan. Aty shihet se norma e fundit e akcizës në duhan është 41 euro për 1,000 copë cigare. Normë të afërt të akcizës në duhan aplikon edhe Shqipëria.¹⁰

Sipas udhëzimeve të BE-së, minimumi i akcizës për 1,000 cigare duhet të jetë 90 euro.¹¹ Arsye për moszbatimin e këtij udhëzimi të BE-së, sipas Ministrisë së Financave, është pamundësia e qytetarëve të Kosovës për të paguar shkallë kaq të lartë të akcizës.¹²

Tabela 1. Ndryshimet në normën e akcizës në duhan 2009-2015

Akti ligjore	Norma e akcizës	Data e hyrjes në fuqi
Ligji 03/L-112	21 €/1000 copë	01.01.2009
Ligji 03/L-220	25 €/1000 copë	12.07.2010
Vendimi 24/53 i datës 21.12.2011	27 €/1000 copë	01.01.2012
Vendimi 07/149 i datës 19.09.2013	30€/1000 copë	01.10.2013
Vendimi 07/149 i datës 19.09.2013	32€/1000 copë	01.01.2014
Vendimi 16/20 i datës 24.03.2015	35 €/1000 copë	24.03.2015
Vendimi 04/39 i datës 22.07.2015	38 €/1000 copë	22.07.2015
Vendimi 11/64 i datës 16.12.2015	41 €/1000 copë	01.01.2016

Burimi: Dogana e Kosovës

3. Efekti i akcizës në import dhe konsum

Në pesë vitet e fundit Kosova ka importuar mesatarisht rreth 56 milionë euro produkte të duhanit brenda vitit. Viti 2011 ka qenë viti me importin më të lartë të duhanit, rreth 3,343 tonelata duhan. Që nga viti 2011, importi ka pësuar rënie. Për shkak të

⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Tatimin në Normën e Akcizës, 31.12.2010, Burimi: <http://bit.ly/1THSPKL>, qasur me 13.03.2016


¹⁰ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligj nr. 158/2014 për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “për akcizat në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, 27.11.2014, Burimi: <http://bit.ly/1Rmf3SS>, qasur me 21.03.2016

¹¹ European Commission, Detyrimet e Akcizës: Cigaret, Burimi: <http://bit.ly/1UaFpgW>, qasur me 13.03.2016

¹² Albinfo, Ulet akciza në vetura, ngrihet në duhan e alkool, Burimi: <http://bit.ly/1SYe9dC>, qasur me 12.03.2016

kontrabandës me këtë produkt, këto shifra jo domosdoshmërisht tregojnë shifrat e sakta të importit të duhanit.¹³

Figura 1. Importi i duhanit gjatë periudhës 2010-2015



Burimi: Dogana e Kosovës

Më poshtë kemi përshkruar trendin e rritjes së akcizës në duhan dhe efektin në import:


- Në janar të vitit 2012, akciza në duhan rritet nga 25 në 27 euro. Krahasuar me vitin paraprak importi i duhanit bie për pesë përqind;
- Në vitin 2013 importi i duhanit bie për dy përqind. Ngadalësimi i rënies së importit të duhanit, mund të ketë ndodhur ngase akciza në duhan rritet vetëm në tetor të atij viti;
- Në vitin 2014, akciza në duhan rritet në janar- nga 30 euro në 32 euro, ndërsa importi bie për gjashtë përqind;
- Akciza në duhan ka vazhduar të rritet edhe në vitin 2015 - nga 32 në 35 euro, ndërsa importi bie për katër përqind.

Mëgjithë rënien e importit të duhanit në kilogram, të hyrat doganore nga importi i duhanit janë rritur mesatarisht tetë

¹³ Koha.net, Shumë kontrabandë me duhan në kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë, Burimi: <http://bit.ly/1o1xaz6>, qasur me 21 mars 2016

përqind në periudhën 2010-2015. Përderisa të hyrat doganore nga duhani në vitin 2010 kanë qenë 93.8 milionë euro, në vitin 2015 ato ishin 134.5 milionë euro. Rritja më e madhe në këto të hyra ka ardhur nga akciza, e cila përbën rreth 75% e të hyrave doganore nga duhani.

Figura 1. Trendet e të hyrave doganore nga duhani ('000)



Burimi: Dogana e Kosovës

Rritja e akcizës përveç se ka ndikuar në rritjen e të hyrave doganore, rrjedhimisht ka rritur edhe çmimin e një pako cigare. Përderisa në dhjetor të vitit 2010 një pako cigare "Ronhill" kushtonte 1.01 euro,¹⁴ në dhjetor të vitit 2015 një pako e tillë cigare kushtonte 1.39 euro.¹⁵


Një ekonomi familjare në Kosovë në vitin 2014 shpenzonte rreth 313 euro (4% të buxhetit familjar për konsum) në vit në alkool dhe duhan,¹⁶ mirëpo konsumi i këtyre dy produkteve ka shënuar rënie viteve të fundit në Kosovë.¹⁷ Në vitin 2013, përqindja e duhanpirësve është ulur për tre pikë përqindje, ndërsa në vitin 2014 ka pasur një rritje të lehtë të numrit të duhanpirësve për një pikë përqindje. Nëse bazohemi në të dhënat e importit, atëherë del se numri i cigareve të konsumuara nga duhanpirësit në vitin 2014 ka shënuar rënie.

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi i Çmimeve të Konsumit Dhjetor 2010, Burimi: <http://bit.ly/1nUqmDa>, qasur me 14.03. 2016

¹⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi i Çmimeve të Konsumit Dhjetor 2015, Burimi: <http://bit.ly/1UKPXLX>, qasur me 12.03. 2016

¹⁶ Përqindje e njëjtë shpenzohet për veshëmbathje dhe mobilie

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (2014), Burimi: <http://bit.ly/21zaiE4>, qasur me 13.03.2016

Figura 3. Përqindja e duhanpirësve në Kosovë.


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Megjithë rritjen e lehtë të përqindjes së duhanpirësve në vitin 2014, përqindja e tyre mbetet më e ulët se në vitin 2012. Përqindja e duhanpirësve mund të ketë rënë, ngase siç u përmend më lartë, çmimi i një pako cigare ka ardhur vazhdimisht duke u rritur si pasojë e rritjes së akcizës në duhan dhe rritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH). Ndikimi negativ në konsum i rritjes së çmimit të cigareve, mbështetet edhe me të dhëna nga shtetet tjera.¹⁸ Faktorë tjetër i cili ka mund të ulë numrin e cigareve të konsumuara dhe duhanpirësve, është edhe miratimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit në vitin 2013 i cili ndalon konsumin e duhanit në hapësirat e mbyllura publike.¹⁹

4. Përfundim

¹⁸ The Cancer Council, Ndikimi i rritjes së çmimit në konsum në Australi, Burimi: <http://bit.ly/1FaG0mk>, qasur me 23.03.2016


¹⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e duhanit, Prill 2013, Burimi: <http://bit.ly/1R8z896>



Të dhënat sugjerojnë se rritja e akcizës, rrjedhimisht shtrenjtimi i çmimit të një pako cigare, kanë ulur përdorimin e duhanit në Kosovë. Zvogëlimi i konsumit të duhanit, ulë shpenzimet publike dhe private në shëndetësi. Kjo për shkak të uljes së numrit të sëmurëve, kontroleve mjekësore, përdorimit të barnave, e kështu me radhë. Në anën tjetër, rritja e akcizës në duhan rrit të hyrat buxhetore dhe mundëson investime të reja publike të cilat rrisin mirëqenien e qytetarit. Prandaj, krahas marrjes së masave për ulje të kontrabandës në import, Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë të rrisë akcizën në duhan.

Aneksi 1

Përqindja e duhanpirësve meshkuj mbi moshën 15 vjeçare në vitin 2012



Burimi: World Health Organization (Organizata Botërore e Shëndetësisë),
<http://bit.ly/1XAdkH9>



Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

